



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 115/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “I...” L.L.C. me seli në Prishtinë, Rr. “...”, nr....., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor – drejtori Sh.K, e të cilin me autorizim e përfaqëson “Avokatura Istrefi” Sh.P.K., kundër debitorit “Telekomi i Kosovës”, Sh.A me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër urdhrin përmbartimor P.nr.478/2018 të datës 03.12.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 26.08.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit numër P.nr.478/2018 i datës 03.12.2018, i lejuar nga Përmbartuesi privat Emine Sherifi – Lubeniqi, me seli në Prishtinë.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 478/2018, i datës 03.12.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi – Lubeniqi, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Emine Sherifi - Lubeniqi me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “I...” LLC, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin për përmbartim me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës: nr. B1486 me të cilën e ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 8.043.79 € (tetë mijë e katërdhjetë e tri euro e shtatëdhjetë e nëntë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e arritjes për pagesë deri në pagesën definitive, si dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kontestuar në tërësi urdhrin e lejuar për përmbartim duke theksuar se urdhri për përmbartim nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përmbartueshëm, përkatësisht se dokumentet e bashkëngjitura propozimit për përmbartim, nuk e

kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sikurse është paraparë në dispozitën e nenit 29 të LPP-së. Më tej ka theksuar se përmbaruesi privat ka nxjerrë urdhrin për përmbarim në kundërshtim me dispozitën e Nenit 40.1.3 të LPP-së, sepse propozimit për përmbarim duhet t'i bashkëngjiten edhe provat respektivisht objekti i përmbarimit në këtë rast fatura kontestuese, si dhe nenit 37 të LPP-së, ku faturat duhet të jenë origjinal – ndërsa në rastin konkret propozimit nuk i janë bashkëngjitur fare faturat origjinale. Ka shtuar se nga faturat e bashkëngjitura propozimit për përmbarim nuk mund të konstatohet nëse malli shërbimi është dorëzuar, se debitori i ka kërkuar këto shërbime dhe se të njëjtat janë përmbushur nga ana e kreditorit. Më tutje ka shtuar se marrëdhëniet kontraktuese ndërmjet debitorit dhe kreditorit janë rregulluar me kontratën “Furnizimi me pajisje dhe punë për zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit broadband” dhe se në rastin konkret palët janë marrë vesh që në rast të mos zbatimit dhe mos përmbushjes së kontratës të i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe jo përmbaruesit privat. Në fund i ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri përmbarimor si dhe të obligohet kreditori i përmbarimit që ti bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se pretendimet e debitorit janë irelevante dhe të paqëndrueshme, ngase fatura në origjinal është dorëzuar në propozimin për përmbarim, në përputhje me nenin 36 par. 1 lidhur me nenin 37 dhe se fatura në bazë të cilës është iniciuar propozimi është paraparë si dokument i besueshëm pikërisht në nenin 29 parag. 1 nënpar. 3 të LPP-së, ndërsa lidhur me pretendimin e debitorit se sa i përket mospërmbushjes së kontratës duhet të ngritet procedurë kontestimore ka deklaruar se pretendimi i tillë është i paqëndrueshëm meqenëse në rastin konkret nuk ka asgjë kontestuese sa i përket zbatimit të kontratës së shërbimeve meqenëse nenin 29 dhe 30 i kontratës parashesh zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sa i përket zbatimit të kontratës e jo me rastin e mospagesës së borxhit nga pala kontraktuese në këtë rast debitori, në këtë çështje. Më tutje ka shtuar se faturat nuk janë kundërshtuar brenda afatit dhe se mallrat dhe shërbimet janë pranuar pa vërejtje nga ana e debitorit. Në fund i ka propozuar Gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji

Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbaremore, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është e përshatshme për përmbaremore, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbaremore me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbaremore po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbaremore paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbaremore për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata konstaton se në këtë çështje përmbaremore urdhri i lejuar nga ana e përmbaremit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën nr. B1486 të datës 05.09.2018 dhe gjeti se fatura i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, pasi që janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj marrëveshje afariste, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në origjinal, mban vulën e pranimit dhe nuk është kontestuar nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se Fatura nr. B1486 në vlerë prej 8,043.79 € (tetë mijë e katërdhjetë e tri euro e shtatëdhjetë e nëntë cent) është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 05.09.2018 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datën 05.09.2018 e cila vërtetohet nga vula e pranimit dhe numri i protokollit nr. nr.04-1-2107/18.

Lidhur me pretendimet e debitorit se në procedurën kontestimore duhet të vërtetohet fakti se nga kontrata a është dorëzuar malli – shërbimi nga ana e kreditorit, Gjykata nuk i morri parasysh këto pretendime, ngase debitori me asnjë provë nuk ka arritur ta dëshmoj se kushti i përcaktuar në dokumentin e besueshëm nuk është përmbushur nga ana e kreditorit, siç kërkohet me dispozitat e Nenit 69 par. 4 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të debitorit se në rastin konkret palët janë marrë vesh që në rast të mos zbatimit dhe mos përmbushjes së kontratës të i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe jo përmbaruesit privat, gjykata gjeti se pretendimi i tillë i debitorit është i pa bazuar ngase procedura përbarimore në këtë çështje është iniciuar për shkak të mos përmbushjes së detyrimit sipas faturës nga ana e debitorit dhe e njëjta përbën dokument të besueshëm sipas LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se urdhri për përbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e Nenit 29 të LPP-së, pasi që nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit e të cilat janë të parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.115/22, datë 26.08.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.